



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH
KESHILLI BASHKIAK BELSH**

Belsh më 10/ 02/ 2026

PROCES – VERBAL

“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 10.02.2026”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

➤ **Janë prezent në mbledhje 14 këshilltarë:**

1. Nexhip Elezi
2. Avni Shtylla
3. Naime Ibrahim
4. Erjon Qafa
5. Kujtim Dervishi
6. Erion Gjoshi
7. Sami Uruçi
8. Gezim Gjoshi
9. Fadil Zdrava
10. Aleksander Idrizi
11. Bujar Blloku
12. Ismail Paja
13. Blerim Kuqja
14. Enkeleda Kullolli

- Kryetari i këshillit hap mbledhjen. Hidhet në votim rendi ditës dhe miratohet me 13 vota pro.
- Hidhet në votim proces verbali i mbledhjes dhe miratohet.
- Hidhet në votim pika nr.1 e rendit të ditës dhe miratohet me 14 vota pro.
- Diskutohet pika nr.2 e rendit të ditës. Prezanton Fatmira Broshka projekt vendimin.
- Ismail Paja: Kush e zbaton programin e transparencës?
- F.Broshka: Programi zbatohet nga Bashkia.
- Hidhet në votim pika nr.2 e rendit të ditës dhe miratohet me 11 vota pro, 2 abstenim dhe 1 kundër.
- Kalojmë në pikën nr.3 të rendit të ditës për përcaktimin e normatives së karburantit. Prezanton p/vendimin Alban Nipolli.
- I.Paja: Si llogaritet harxhimi i mjeteve, kush i mban shënim?

- A.Nipolli: Matja bëhet me kilometra dhe me orë pune me proces verbal nga punonjësit përgjegjës.
- Blerim Kuqja: Shoh një relacion të cunguar dhe nuk shikoj koston totale të harxhimit të mjeteve.
- A.Nipolli: Është detyrë ligjore miratimi i harxhimit mbi bazën e matjeve dhe faktit.
- B.Kuqja: Kërkojmë informacion për harxhimin e karburantit për vitin 2025.
- Sami Uruçi: Është një makinë zjarrfikëse që harxhon 12 litra, besoj që duhet bërë matje sepse harxhon më shumë mendoj nëse matja bëhet saktë.
- Fadil Zdrava: Mjeti Volksäagen harxhon 15 lit/100 km. Si është e mundur?
- A.Nipolli : Ju lutem ngrini komisionet dhe mund ti verifikoni në terren se sa harxhojnë mjetet.
- Hidhet në votim pika nr.3 dhe miratohet me 11 vota pro, 2 abstenim dhe 1 kundër.
- Kalojmë te pika nr. 4 e rendit të ditës për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzara.Prezanton p/vendimin Dr.Financës A.Nipolli.
- Sami Uruçi: Është për të gjithë vitin?
- A.Nipolli: Po, është bërë inventari për vitin 2025.
- I.Paja: Ku ndodhen këto materiale?
- A.Nipolli: Materialet gjenden në shkolla, zyra etj...
- Hidhet në votim pika nr.4 dhe miratohet me 11 vota pro dhe 3 vota abstenim.
- Kalojmë te pika nr.5 e rendit të ditës "Shtesë buxheti për vitin 2026".
- Prezanton A.Nipolli. Diskuton që janë 2 projekt vendime për shtesë buxheti 2026 sepse ashtu e kërkon udhëzimi.
- Kujtim Dervishi: Diskutojmë p/vendimin me nr prot.378. Kush ka pyetje?
- Erion Gjoshi: Janë 4 kontrata, a do të zbatohen për 2026?
- A.Nipolli : Po, dhe ne e kemi për detyrim planifikimin e këtyre kontratave.
- B.Kuqja : Shpresoj që viti 2026 të ketë më shumë investime se vitin e kaluar në interes të qytetarëve.
- Kujtim D: Besoj që Bashkia ka investuar në disa rrugë dhe shumë projekte kërkojnë edhe ndihmën e qeverisë.
- Hidhet në votim pika nr.5 dhe miratohet me 11 vota pro dhe 3 kundër.
- Diskutohet p/vendimi i 2-të për shtesën e buxhetit me nr prot.379.
- E.Gjoshi: Ku konsiston plani për barazinë gjinore?
- A.Nipolli: Parashikohet që të lidhet një kontratë me një subjekt të specializuar që ta përpilojë planin.
- Hidhet në votim shtesa nr.2 dhe miratohet me 12 vota pro dhe 2 abstenim.
- Kalojmë te pika nr.7 e rendit të ditës për ndryshimin e vkb nr.54 dt.24.12.2025 për përcaktimin e nivelit 4% për taksë ndikimi në infrastrukturë.
- Hidhet në votim pika nr.7 dhe miratohet me 11 vota pro, 2 kundër dhe 1 abstenim.
- Kalojmë te pika nr.6 e rendit të ditës "Për miratimin e paktit të miqësisë me Bashkinë Lugo në Republikën e Italisë. Prezanton p/vendimin Paolina Rusta.
- K.Dervishi : Kusht për integrimin në BE është që të kemi një binjakëzim me një Bashki të BE.
- P.Rusta : Ky është hap i parë që binjakëzimi të bëhet.
- Hidhet në votim pika nr.6 dhe miratohet me 13 vota pro dhe 1 kundër.


- Diskutohet pika nr.8 e rendit të ditës “Për miratimin e kontratës me ECO-ELB. Mbron Anxhelina Qypi projekt vendimin.
- I.Paja: E kemi miratuar grumbullimin për Green Belsh.
- A.Qypi: Kjo kontratë nuk ka lidhje me grumbullimin që bën Green në terren.
- B.Kuqja: Pse vendimi nuk është shoqëruar me një analizë kostoje?
- A.Qypi: Jo, nuk ka analizë kostoje sepse është miratuar nga ky këshill.
- B.Kuqja : A është parë alternativë tjetër?
- A.Qypi : Nuk ka alternativa të tjera.
- Hidhet në votim p/vendimi nr.8 dhe miratohet me 11 vota pro dhe 3 kundër.
- Diskutohet pika nr.9 e rendit të ditës.
- S.Uruçi: Kush do i paguajë paratë për djegien e shtëpisë dhe humbjen e jetës?
- Ndriçim Qose: Fondi i kushtëzuar jepet nga Ministria dhe AKMC.
- Hidhet në votim pika nr.9 dhe nuk miratohet me 10 vota pro ,3 kundër dhe 1 abstenim.
- Ismail Paja: Kërkojmë informacion mbi listën totale të punonjësve të Bashkisë dhe strukturën dhe emrat. Gjithashtu kërkojmë informacion mbi listën e krypleqve për çdo fshat.
- Në përfundim të gjithë këshilltarët dëgjojnë një video mesazh të kryetares së Bashkisë së Lugo-s, e cila u drejtohet këshilltarëve të Bashkisë Belsh.
-

Mbyllet mbledhja me 9 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA



+